

Raport mbi Qeverisjen në katër Komunitat Veriore

Shtator 2015



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dy vite pas zgjedhjeve të nëntorit 2013, kryetarët e komunave të veriut¹ nuk i kanë konstituuar organet komunale të ekzekutivit. Të vetmet organe të formuara pas zgjedhjeve të nëntorit 2013 janë kuvendet komunale. Kuvendet komunale në komunat veriore kanë finalizuar statutet e komunave, të cilat janë pranuar si të ligjshme nga ana e MAPL-së. Në asnjë nga këto statute nuk figuron logoja, vula dhe simbolet e komunës.

Kryetari i Mitrovicës së Veriut i ka nxjerr dy vendime duke u thirrur në mandatin e fituar nga zgjedhjet e Kosovës. Të dy këto vendime janë cilësuar të jashtëligjshme nga ana e MAPL: ndërtimi i të ashtuquajturit “Parku i Paqes” në urën e lumit Iber dhe ndërtimi i sheshit “Car Llazar”. Kryetari i Mitrovicës së Veriut ka shpërfillur rekomandimet e dhëna nga MAPL në këto dy raste.

Kryetarët e komunave Leposaviq, Zhubin Potok dhe Zveçan ushtrojnë funksione të dyfishta: ata janë zgjedhur kryetar nga zgjedhjet lokale të Kosovës, paguhen nga buxheti i Kosovës dhe në të njëjtën kohë kanë pranuar funksione nga Qeveria e Serbisë për t’i udhëhequr me strukturat paralele. Komunitatet paralele në veriun e Kosovës quhen “Organet e Përkohshme Administrative”. Këto organe nxjerrin vendime për sektorin e arsimit, administratës, shëndetësisë, urbanizimit, shërbimeve publike si dhe për sport dhe kulturë. Kryetarët që kanë dal nga zgjedhjet lokale të Kosovës qëndrojnë në objektet e komunave paralele dhe nuk pranojnë të identifikohen me ndonjë shenjë apo simbol të shtetit të Kosovës.

Qeveria e Kosovës nuk ka nxjerr asnjë vendim në lidhje me shuarjen apo transformimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut. Kjo zyre ishte paraparë të funksionojë vetëm deri në formimin e Komunës së Mitrovicës së Veriut. Në këtë zyre të punësuar janë 59 persona, 7 nga ta mbajnë pozitën e drejtorëve të Drejtorive. Drejtorët janë emëruar nga udhëheqja e ZAMV-së Adriana Hoxhiq dhe jo nga kryetari në veri të Mitrovicës i dal nga zgjedhjet e Kosovës Goran Rakiq.

Për 2015, komunat në veri kanë në dispozicion nga Buxheti i Republikës së Kosovës 10.8 milionë euro. Prej kësaj shume mbi 6.2 milionë euro janë paraparë të shpenzohen për paga. Në katër komunat e veriut të Kosovës në nivel lokal figurojnë 1,730 persona që tërheqin pagë nga buxheti i Kosovës. Numri më i madh i atyre është në Komunën e Mitrovicës së Veriut, ku figurojnë 747 persona. Pjesa më e madhe e këtij stafi tërheq nga dy paga për punën e njëjtë që bëjnë, njëren pagë e paguan buxheti i Kosovës dhe një pagë e tërheqin nga Qeveria e Serbisë.

Përveç kësaj, për këto komuna është formuar edhe “Fondi Zhvillimor për Veriun”, i cili mbushet kryesisht nga të hyrat doganore nga pika 1 dhe 31

¹ Mirovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zhubin Potok.

(Bernjak dhe Jarinjë). Nga janari 2014 deri në gjysmën e dytë të muajit korrik 2015 në këtë Fond janë derdhur 6.5 milionë euro.

1. Sistemi paralel i qeverisjes në komunitet e veriut të Kosovës

Marrëveshja e Brukselit e 19 prillit 2013 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që i referohet kryesisht veriut të Kosovës, nuk ka sjellë edhe shuarjen e strukturave paralele të qeverisjes në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicën e Veriut.² Marrëveshja adreson kryesisht integrimin e policisë, gjyqësisë, krijimin e Asociacionit, telekomin, energjetiken dhe mbajtjen e zgjedhjeve lokale.³

As mbajtja e zgjedhjeve lokale në nëntor të 2013 edhe në katër komunitet e veriut dhe zgjedhja e përfaqësuesve lokal nuk ka bërë që strukturat paralele të shuhen.

Këto struktura kanë ndikim në të gjitha fushat e jetës publike në komunitet e veriut të Kosovës. Me sugjerimin e Beogradit këto struktura kanë larguar emërtimin "komuna" dhe kanë vendosur emërtimin "Organe të Përkohshme Administrative".⁴ Përveç këtij ndryshimi, këto struktura kanë mbetur të njëjta në funksione dhe në hierarki me kohën e para mbajtjes së zgjedhjeve lokale 2013.

"Organet e Përkohshme Administrative" (strukturat paralele) udhëhiqen nga kryetari dhe janë të organizuara në drejtori dhe departamente, kanë buxhet të aprovuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Serbisë të cilës edhe i raportojnë.⁵ Si kryetarë të komunave paralele në Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok, Qeveria e Serbisë ka emëruar po ata individë që kanë fituar mandatin e kryetarit nga zgjedhjet e Kosovës.⁶

² Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullon Normalizimin e Marrëdhënieve. 19.04.2013. Burimi: <http://bit.ly/1CIGNDN>

³ Ibid.

⁴ Intervistë me Zëvendës-kryesuesin e Kuvendit Komunal të Mitrovicë së Veriut Emir Azemi. Intervistë është zhvilluar me date 17.04.2015.

⁵ Ibid.

⁶ Qeveria e Kosovës. Raporti mbi Implementimin e Marrëveshje të Brukselit. Mars 2015. F 10. Burimi: <http://bit.ly/19fMLUI>

Komunat paralele në katër komunitet e veriut të Kosovës strukturën e organizimit e bazojnë në modelin e qeverisjes lokale të Serbisë.⁷ Të gjitha dokumentet dhe aktivitetet që organizohen dhe sponsorizohen nga këto organe mbajnë vulën dhe stemën e Serbisë.

Kryetarët e zgjedhur nga zgjedhjet lokale të Kosovës nuk i kanë emëruar gjithë drejtorët e drejtorive. Kanë bërë emërimin e disa drejtorëve (atë për buxhet, shëndetësi, arsim dhe urbanizëm). Në tri komunitet e të veriut të Kosovës (Mitrovica e Veriut, Leposaviq dhe Zveçan) të emëruarit si drejtor të drejtorive, ushtrojnë funksione edhe në komunat paralele.⁸

Më shumë se një vit pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në Kosovë, Qeveria e Serbisë përmes një vendimi ka emëruar kryetarët e zgjedhur në zgjedhjet e Kosovës, në pozitë të udhëheqësve të "Organeve të Përkohshme Administrative". Kësisoj, Vuçina Janković në Zveçan, Dragan Jablanović në Leposaviq, Stevan Vulović në Zhubin Potok janë edhe kryetar të zgjedhur në zgjedhjet e Kosovës, dhe në të njëjtën kohë kanë pranuar të udhëheqin komunat paralele me vendim nga Serbia. Për Mitrovicën e Veriut, për kryetar të komunës paralele Serbia ka emëruar Aleksander Spiriq, kursekryetari i dal nga zgjedhjet e Kosovës Goran Rakiq e ka emëruar atë nënkryetar të tij.⁹

Komunat paralele të qeverisjes, ofrojnë shërbime të gjendjes civile, duke lëshuar dokumente, nga certifikata të lindjes, letërnjoftime dhe dokumentet tjera. Të gjitha këto lëshohen sipas modelit të standardizuar të Serbisë. Komunat paralele mbajnë mbledhje të rregullta javore dhe hartojnë raporte të cilat i dorëzohen Ministrisë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë. Këto organe kanë kontroll të plotë në arsim, kulturë dhe shëndetësi.

Plan programi mësimor është i bazuar në modelin e Serbisë, tekstet mësimore sigurohen falas nga Ministria e Arsimit e Qeverisë së Serbisë, ndërsa certifikatat dhe diplomat lëshohen sipas numrit rendor të po kësaj ministrie.

⁷ Intervistë me Florim Kelmendin. Nënkyetar për Komunitete në Komunën e Zveçanit. Intervista është realizuar me datë 28.04.2015.

⁸ Intervista më përfaqësuesit shqiptarë në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zhubin Potok dhe Zveçan. Në Mitrovicën e Veriut është intervistuar Emir Azemi, Zëvendës-kryesues i Kuvendit Komunal. Në Zveçan është intervistuar Florim Kelmendin, Nënkyetar për Komunitete. Në Leposaviq është intervistuar Shemsi Bektashi, nënkryetar për komunitete, ndërsa në Zubin Potok është intervistuar Agim Hasani, nënkryetar për komunitete.

⁹ Qeveria e Kosovës. Raporti mbi Implementimin e Marrëveshje të Brukselit. Mars 2015. F 10. Burimi: <http://bit.ly/19fMLUI>

Kryetarët e komunave në veri deri më tani kanë nxjerrë vendime që janë në kundërshtim me ligjet e Kosovës dhe me parimet e përgjithshme të Marrëveshjes së Brukselit.

Kësisoj, Kryetari i Mitrovicës së Veriut (Goran Rakiq) ka nxjerrë vendime për ndërtimin e sheshit "Car Lazar" përgjatë vijës së lumit Iber në pjesën veriore. Sipas akteve nënligjore të hartuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nisja e ndërtimit të shesheve bëhet vetëm pasi të finalizohet dhe miratohen planet rregulluese dhe planet urbanistike dhe këto plane mund të miratohen vetëm pasi komuna ta ketë nxjerrë Planin Zhvillimor Komunal.¹⁰ Mitrovica e Veriut nuk i ka të miratuara asnjërën nga këto dokumente.¹¹

Kryetari Goran Rakiq ka shpërfillur edhe shkresat ligjore të MAPL. Kjo e fundit e ka cilësuar si jo ligjor vendimin e Komunës së Mitrovicës së Veriut për të ngritur pengesë mbi urën kryesore që lidh pjesën veriore me atë jugore të qytetit të Mitrovicës. Edhe përkundër kësaj shkrese, Kryetari Rakiq nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim në zbatimin e vendimit të MAPL.¹²

Kryetarët e veriut të dal nga zgjedhjet lokale të Kosovës i ushtrojnë funksionet e tyre në objektet që i shfrytëzojnë komunat paralele. Koha dhe aktiviteti i tyre kryesisht fokusohet në menaxhimin e organeve paralele dhe ofrimin e shërbimeve përmes këtyre organeve.

identifikohen disa nga sfidat që ndërlidhen me implementimin e FKGK-së, si dhe të ofrohen rekomandime për menaxhimin e tij.

2. Pagat e dyfishta në veriun e Kosovës

Janë dy banka që operojnë në veriun e Kosovës të cilat janë të regjistruara dhe të certifikuara nga Banka Qendrore e Serbisë dhe jo

¹⁰ Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Udhëzim Administrativ. Elementet Themelore të Planit Zhvillimor Urban. Nr.30/3. Burimi: <http://bit.ly/1VtfV5K>

¹¹ Intervistë me Agron Maxhuni, drejtor i Zyrës Ligjore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Intervista është zhvilluar me datë 15.04.2015

¹² Qeveria e Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Shkresë Ligjore. 25.06.2014. Burimi: <http://bit.ly/1bpdS0k>

ajo e Kosovës. Në veri të Kosovës funksionojnë “JugoBanka” dhe “Dunav Banka”.¹³

Operimi i bankave në formë paralele ka bërë që personat e punësuar nga komuniteti serb të kenë të lehtë tërheqjen e pagave nga Serbia dhe në të njëjtën kohë të tërheqin pagë edhe nga buxheti i Republikës së Kosovës.¹⁴

Në veri të Kosovës shitblerjet dhe pagesat bëhen kryesisht me dinarë të Serbisë. Edhe pagat nga Serbia pranohet në dinarë.¹⁵ Deri në vitin 2012 të gjitha pagesat në veri nga Serbia janë kryer përmes postes. Pastaj është shmangur kjo praktik dhe ka nisur të përdoret sistemi paralel bankar në shpërndarjen e pagave.¹⁶

Tërheqja e pagave të dyfishta bëhet nga një pjesë e stafit të administratës komunale, stafit të arsimit dhe nga disa persona nga ndërmarrjet shoqërore. Një numër i konsiderueshëm i serbeve lokale edhe në këto institucione refuzojnë të futen në sistemin e pagave të Republikës së Kosovës.¹⁷

Edhe Qeveria e Kosovës e pranon ekzistimin e pagesave të dyfishta në veriun e Kosovës dhe e konsideron edhe me tutje sfidë hartimin e listave të pagave.¹⁸

Auditori i Përgjithshëm i Kosovës ka hasur raste në të katër komunat e veriut që punonjësit publik nuk kanë kontrata të rregullta të punës, madje në disa raste auditori nuk ka qenë në gjendje të verifikojë nëse personeli që paguhet është në të vërtetë i angazhuar.¹⁹

Nga muaji shkurt 2015 deri në javën e dytë të muajit prill xhirollogaritë bankare të Kosovës që shfrytëzohen nga komunat e veriut kanë qenë të bllokuara nga Ministria e Financave e Kosovës.

¹³ Qeveria e Kosovës. Zyra e Koordinatorit për Strategjinë e Veriut. Faqe 55. Maj 2011. Burimi: <http://bit.ly/1KCnvI7>

¹⁴ Intervistë me Zëvendës-kryesuesin e Kuvendit Komunal të Mitrovicë së Veriut Emir Azemi. Intervistë është zhvilluar me date 05..08.2015.

¹⁵ Qeveria e Kosovës. Zyra e Koordinatorit për Strategjinë e Veriut. Faqe 54. Maj 2011. Burimi: <http://bit.ly/1KCnvI7>

¹⁶ Intervistë me Zëvendës-kryesuesin e Kuvendit Komunal të Mitrovicë së Veriut Emir Azemi. Intervistë është zhvilluar me date 05..08.2015.

¹⁷ Ibid.

¹⁸ Qeveria e Kosovës. Raporti mbi Implementimin e Marrëveshje të Brukselit. Janar -Shtator 2014. F 12. Burimi: <http://bit.ly/1Fol4WT>

¹⁹ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit. 2014. Komuna e Zveçanit. Fq 21. Burim: <http://bit.ly/1ig47Wg> & Komuna e Mitrovicës së Veriut. Fq 21. Burim: <http://bit.ly/1MZKUTU>

Kjo ka ardhur pasi që të katër komunat e veriut kanë tentuar që përmes miratimit të buxhetit të legjitimojnë sistemin e pagave që marrin nga Serbia, duke ia dedikuar të drejtën e dhënies së pagave në arsim dhe shëndetësi Asociacionit të Komunave Serbe që parashihet të formohet.²⁰

Në katër komunat e veriut të Kosovës tërheqin pagë 1,730 persona, pa llogaritur këtu numrin e policëve, punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore dhe sektorëve të tjerë që nuk përkrijnë me nivelin lokal të qeverisjes.²¹ Pjesa më e madhe e pagave tërhiqen në sistemin arsimor.

Tabela.nr1: Numri i personave që tërheqin pagë nga buxheti i Kosovës në katër komunat e veriut sipas sektorëve.²²

Komunat	Administratë	Arsim	Shëndetësi	Totali
Leposaviq	81	332	3	416
Zubin Potok	113	207	11	331
Zveçan	76	170	5	251
Mitrovica e Veriut	103	404	225	732
Totali	373	1,113	244	1,730

Stafi që punon në sistemin shëndetësor në Leposaviq, Zubin Potok dhe në Zveçan në tërësi kanë refuzuar të përfshihen në listat e pagave të Republikës së Kosovës.

3. Shpenzimet e buxhetit të Kosovës në veri

Komunat e veriut të Kosovës përveç buxhetit që tërheqin nga Republika e Kosovës në formë të granteve për komuna, ato tërheqin edhe projekte nga ministritë e linjës të Qeverisë së Kosovës, donacione ndërkombëtare dhe të hyra nga Serbia.

Komunat e veriut, njësoj sikur komunat tjera të Kosovës, pranojnë buxhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës për paga, për mallra dhe

²⁰ European Centre For Minority Issues Kosovo. 7 maj 2015. Buxhetet e komunave veriore të Kosovës. Versioni në gjuhën shqipe. Burim: <http://bit.ly/1P41MMF>


²¹ Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raporti I shpenzimit të buxhetit. Janar-mars 2015. Faqe 20. Burimi: <http://bit.ly/1HkFfq8>

²² Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Buxheti për vitin 2015. Pjesa e Komunave. Burim: <http://bit.ly/19buQ1u>

shërbime, për investime kapitale, për subvencione dhe për shpenzime komunale.

Për dallim nga komunat e tjera të Kosovës të cilat realizojnë të hyra komunale, komunat e veriut janë paraqitur vetëm shpenzues të buxhetit, por jo edhe si institucione që kontribuojnë në të hyra. Gjatë vitit 2014 katër komunat e veriut kanë realizuar të hyra në total 70 mijë euro.²³ Këto të hyra janë realizuar nga Zyra Komunale për Komunitete që udhëhiqen nga shqiptarët. Këto zyre funksionojnë jashtë objekteve të komunës. Në Leposaviq zyra gjendet në fshatin Bistricë, në Zveçan gjendet në fshatin Lipë dhe në Zubin Potok gjendet në fshatin Çabër.²⁴ Ndonëse këto zyra janë të parapara vetëm për të promovuar të drejtat e komuniteteve jo shumicë, ato ushtrojnë edhe funksione të dhënies së dokumentacionit civil dhe është në rritje numri i serbëve lokal që marrin dokumentet e Republikës së Kosovës, kryesisht për arsye të pensioneve.

Katër komunat e veriut të Kosovës gjatë vitit 2015 kanë në dispozicion nga buxheti i Republikës së Kosovës 10.8 milionë euro.²⁵



Burimi: Ministria e Financave

Nga 10.8 milionë euro të buxhetit të Kosovës në komunat e veriut, 58% dedikohen për paga, 34% për investime kapitale, 6% për mallra dhe shërbime dhe nga 1% për subvencione dhe po kaq për shpenzime komunale.


²³ Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Ligji për Buxhetin 2014. Faqe 13.

Burimi: <http://bit.ly/19buQ1u>

²⁴ Intervistë me Florim Kelmendin. Nënkyetar për Komunitete në Komunën e Zveçanit. Intervista është realizuar me date 28.04.2015.

²⁵ Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Buxheti për vitin 2015. Janar –Mars. Pjesa e Komunave. Burim: <http://bit.ly/1HkFfq8>

Buxheti sipas kategorive për katër komunat e veriut - 2015



Komunat e veriut nuk publikojnë asnjëherë raporte në lidhje me shpenzimet e realizuara nga buxheti i Kosovës. Edhe përkundër funksionimit të kuvendeve komunale në veri pas zgjedhjeve të 2013 kryetarët e komunave nuk kanë paraqitur asnjë raport para kuvendeve në lidhje me shpenzimet e buxhetit të Kosovës.²⁶


4. Fondi për veriun

Komunat e Veriut të Kosovës, përveç fondeve që do t'i marrin në linjën e granteve nga Qeveria e Kosovës, do të kenë në dispozicion edhe një fond të veçantë, "Fondin Zhvillimor për Veriun e Kosovës".

Marrëveshja për krijimin e fondit për veriun është arritur më 17 janar 2013 në Bruksel mes Kosovës dhe Serbisë. Me 25 korrik 2013 ky Fond është inkorporuar në ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin (nr. 04-L-165) i miratuar në Kuvendin e Kosovës.²⁷ Po ashtu, Kuvendi i Kosovës ka bërë ndryshime të Ligjeve të Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore për të mundësuar funksionalizimin e fondit.

²⁶ Intervistë me Zëvendës-kryesuesin e Kuvendit Komunal të Mitrovicë së Veriut Emir Azemi. Intervistë është zhvilluar me date 05.08.2015.

²⁷ Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raporti financiar për vitin 2014. Fq 31. Burim: <http://bit.ly/1HkFfq8>



Fondi iu mundëson komunave në veri që t'i prezantojnë projektet zhvillimore dhe të tërheqin para për financimin e tyre. Ky fond grumbullohet nga të hyrat e mbledhura në pikëkalimet në Jarinjë/Rudnicë dhe në Bërnjak/Tabavije (detyrimet e aplikueshme dhe taksat e akcizës, përfshirë TVSH-në) dhe nga kompanitë që operojnë dhe mallrat që destinohen për popullatën lokale të komunave të pjesës veriore do të barten në Fondin Zhvillimor. Në Fond mund të kontribuojnë edhe Serbia, BE-ja dhe donatorët tjerë ndërkombëtarë.²⁸

Bordi menaxhues i fondit përbehet nga një përfaqësues i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, një përfaqësues nga Ministria e Financave e Qeverisë së Kosovës dhe një përfaqësues i deleguar nga komunitatet e veriut të Kosovës.

Fondi ka xhirollogarinë në një nga bankat që operojnë në Kosovë . Në pikëkalimet kufitare 1 dhe 31 në veri të Kosovës, doganat gjatë vitit 2014 kanë zhdoganuar mallra në vlerë 4.6 milionë euro dhe gjitha këto para janë dedikuar në Fondin për Veriun e Kosovës. Ndërsa gjatë 2015, gjegjësisht nga janari deri gjysmën e dytë të muajit korrikut të 2015 nga pikëkalimi kufitar 1 dhe 31 janë dedikuar në Fondin e veriut rreth dy milion euro. Nga kjo rezulton se Fondi për Veriun deri në korrik të 2015 ka në dispozicion 6,522,299 milionë euro.²⁹ Përmbajtja e mallrave që kanë hyrë në pikën 1 dhe 31 sipas Doganave të Kosovës kryesisht kanë qenë ushqimore, por ka pasur trend të rritjes edhe të mallrave ndërtimore, të tekstilit dhe pasjeve mekanike dhe teknike dhe sasi krejtësisht e vogël e zhdoganimeve të derivateve.

²⁸ Qeveria e Kosovës. Raporti mbi Implementimin e Marrëveshje të Brukselit. 2015 dhe 2014. Burimi: <http://bit.ly/19fMLU1> dhe <http://bit.ly/1Fol4WT>

²⁹ Doganat e Kosovës. Bisedë me Adriatik Stavilecin, zëdhënës i Doganave të Kosovës. Biseda është zhvilluar me date 24.4.2015 dhe me 5.08.2015

5. Përfundim

Që nga themelimi i institucioneve të para të Kosovës në tetor të vitit 2000, komunat e veriut kanë kundërshtuar bashkëpunimin me institucionet e Kosovës. Këto komuna kanë pranuar deri në vitin 2007 një bashkëpunim të pjesshëm me UNMIK-un. Pas këtij viti, këto komuna kanë kundërshtuar pavarësinë e Kosovës dhe nuk kanë pranuar t'i zbatojnë ligjet dhe rekomandimet e institucioneve të Kosovës.

Kjo gjendje ka mundësuar forcimin dhe zgjerimin e administratës paralele në komunat e veriut, sipas udhëzimeve të Qeverisë së Serbisë.

Bisedimet në Bruksel për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë dhe arritjes së disa marrëveshjeve gjendja në veri ka pasur disa ndryshime. Janë mbajtur zgjedhjet lokale sipas sistemit të Kosovës, janë formuar dhe funksionalizuar kuvendet komunale, janë miratuar statutet e komunave, është krijuar fondi i veriut dhe ka pasur një rritje të bashkëpunimit veçmas mes përfaqësuesve të veriut të Mitrovicës dhe atyre të jugut.

Deri më tani institucionet e Kosovës janë treguar të pafuqishme kundrejt këtyre strukturave dhe shpresën në shuarjen e tyre e bazojnë në ushtrimin e presionit nga Brukseli tek Beogradi për të ndaluar mbështetjen për këto struktura.

Qeveria e Kosovës do të duhet të nxjerrë një vendim për transformimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut në Komunë të Mitrovicës së Veriut. Kjo do të lehtësonte dhe përshpejtonte ecurinë e formimit të Komunës së Mitrovicës së Veriut. Ekzistimi edhe me tutje i kësaj zyre brenda kompetencave të parapara me aktin e formimit të saj e benë edhe me të mjegullt hierarkinë e autoriteteve të ligjshme në veri të Mitrovicës.

Pamundësia e institucioneve të Kosovës për të ndaluar pagat e dyfishta në veri, inkurajon jetën paralele në atë pjesë të vendit. MAPL si instancë qendrore do të duhet të dizajnonte faqet zyrtare në internet për komunat e veriut dhe t'i udhëzonte krerët e këtyre komunave për publikimin e gjitha aktiviteteve dhe dokumenteve nga fushat relevante të qeverisjes lokale.

Burimet

1. Administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Zyra në Mitrovicën e Veriut. Përshkrimi i funksioneve. Burimi: <http://bit.ly/1UjE4yv>
2. Doganat e Kosovës. Bisedë me Adriatik Stavilecin, zëdhënës i Doganave të Kosovës.
3. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për ndarjen e kufijve Administrativ të Komunave. Burimi: <http://bit.ly/1N6X2nT>
4. Intervistë me Florim Kelmendin. Nënkyetar për Komunitete në Komunën e Zveçanit.
5. Intervistë me nënkryetarin për komunitete në Komunën e Leposaviqit, Shemsi Bekteshi.
6. Intervistë me nënkryetarin për komunitete në Komunën e Zubin Potokut, Agim Hasani.
7. Intervistë me Zëvendës-kryesuesin e Kuvendit Komunal të Mitrovicë së Veriut Emir Azemi.
8. Komuna e Prishtinës. Web faqja Zyrtare. Numri i Drejtorive. Burimi: <http://bit.ly/1UjFdpV>
9. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Intervistë me Agron Maxhunin, Drejtori i Zyrës Ligjore.
10. Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Udhëzim Administrativ. Elementet Themelore të Planit Zhvillimor Urban. Nr.30/3. Burimi: <http://bit.ly/1VtfV5K>
11. Qeveria e Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Konfirmim i Ligjshmërisë së Statutit të Mitrovicës së Veriut. 15.05.2014. Burimi: <http://bit.ly/1DP8FKq>
12. Qeveria e Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Shkresë Ligjore. 25.06.2014. Burimi: <http://bit.ly/1bpdS0k>
13. Qeveria e Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Udhëzim Administrativ. 2008/3. Transparenca nëpër komuna. Burimi: <http://bit.ly/1Fkzirl>
14. Qeveria e Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Konfirmim i Ligjshmërisë së Statutit të Komunës së Leposaviqit. Burimi: <http://bit.ly/1OlrXxL>
15. Qeveria e Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Konfirmim i Ligjshmërisë së Statutit të Komunës së Zubin Potokut. Burimi: <http://bit.ly/1QvpYpb>
16. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Ligji për Buxhetin 2015. Burimi: <http://bit.ly/19buQ1u>
17. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Qarkorja buxhetore për nivelin lokal. Burimi: <http://bit.ly/1JJufhZ>
18. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raportet e shpenzimeve financiare 2013 & 2014. Burimi: <http://bit.ly/1HkFfq8>
19. Qeveria e Kosovës. Raporti mbi Implementimin e Marrëveshje të Brukselit. Mars 2015. Burimi: <http://bit.ly/19fMLU1>
20. Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Vendim 01/75. 23.05.2012. Burimi: <http://bit.ly/1GxeKhe>
21. Zyra e Kombeve të Bashkuara e Përfaqësuesit Special për Kosovë. Plani Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Aneksi i decentralizimit. Burimi: <http://bit.ly/1IDmJVd>



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtisë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtisë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Programi i qeverisjes lokale të GAP mbështetet nga:

